

DEKLARATË
PËR RUAJTJEN E KONFIDENCIALITETIT

të Paketës së të Dhënave të Vendburimit _____

I nënshkruari _____, deklaron se përfaqëson
(emri i nënshkruesit të këtij formulari)

_____, më poshtë referuar
(emri zyrtar në tërësi, forma zyrtare ligjore, adresa zyrtare e personit juridik),

si "**Marrësi**".

Duke pasur parasysh se Marrësi ka për qëllim të lidh një Marrëveshje Hidrokarbure për Vendburimin _____, Albpetrol sh.a. do të vendos në dispozicion të tij disa informacione **konfidenciale** (siç janë përcaktuar më poshtë). Si kusht për dhe në konsideratë të dhënies nga Albpetroli të informacionit konfidencial, Marrësi bie dakord për angazhimet që përmban kjo **Deklaratë**.

Marrësi pranon se të gjitha informacionet e vendosura në dispozicion nga Albpetrol SH.A tek Marrësi, në një kopje të printuar dhe në një CD, që përmbajnë të ashtuquajturën "**Paketa e të Dhënave**" do të konsiderohen si informacione konfidenciale ("*informacione konfidenciale*"). Ky informacion konfidencial lidhet (pa u kufizuar) me të dhënat teknike, zhvillimet apo produktet, të dhënat gjeologjike, të prodhimit të Albpetrol-it dhe të tjera, qoftë me shkrim, grafik ose formë elektronike në lidhje me Vendburimin _____.

Marrësi pranon gjithashtu:

- të përdori informacionin konfidencial vetëm për qëllimin e lidhjes së Marrëveshjes Hidrokarbure me Albpetrol SH.A.;
- të përdori të gjitha mjetet e mundshme për ta ruajtur këtë informacion në konfidencë të plotë dhe të paktën ato masa që ai përdor për mbrojtjen e informacionit të tij konfidencial, por në çdo rast jo më pak se në një shkallë të arsyeshme kujdesi;
- ta ndajë këtë informacion konfidencial vetëm për Përfaqësuesit¹ e Marrësit ose punonjësit e veçantë të nënkontraktorëve, të cilët kërkohet të kenë informacion vetëm për qëllime të plotësimit të Formularit të Aplikimit dhe, sipas rastit, për lidhjen e Marrëveshjes Hidrokarbure, dhe me të cilët duhet të ketë nënshkruar më parë një marrëveshje konfidencialiteti me përmbajtje të ngjashme me parashikimet këtu;

¹ Termi "Përfaqësues" nënkupton referuar Marrësit, shoqërië e tij kontrolluese ose shoqëritë e kontrolluara - punonjësit e tyre, personat e autorizuar për të përfaqësuar shoqërinë sipas ligjit, agjentët dhe personat e tjerë që kanë të drejtë të veprojnë në emër të Marrësit sipas ndonjë kontrate (duke përfshirë këshilltarët financiarë, konsulentët dhe kontabilistët).

- të mos bëjë asnjë kopje të informacionit konfidencial të përfituar në përputhje me këtë Deklaratë pa lejen me shkrim të Albpetrol SH.A., me përjashtim të rastit kur është e nevojshme për qëllime të paraqitjes së Formularit të Aplikimit ose të lidhjes së një Marrëveshjeje Hidrokarbure;
- të njoftojë menjëherë me shkrim Albpetrol SH.A. në rast të ndonjë përdorimi të paautorizuar ose shpërndarjes së të këtij informacioni konfidencial.

Të gjitha informacionet konfidenciale mbeten pronë e Albpetrol SH.A dhe asnjë licencë ose të drejta të tjera në informacionin konfidencial nuk janë dhënë me anë të kësaj, përveç siç parashikohet shprehimisht më sipër. Kjo Deklaratë nuk përbën asnjë kontratë, partneritet apo marrëveshje tjetër biznesi.

Marrësi pranon që shpërndarja e paautorizuar ose përdorimi i informacionit konfidencial mund të shkaktojë dëm të pariparueshëm, që mund të jetë i vështirë të përcaktohet. Prandaj, Marrësi bie dakord që Albpetrol SH.A do të ketë të drejtën të kërkojë dhe të marrë dëmshpërblim, nga shkeljet e angazhimeve të Marrësit sipas kësaj Deklarate, pavarësisht çdo të drejte dhe mjeti tjetër që mund të ketë.

Detyrimet e Marrësit këtu, do të zgjasin derisa i gjithë informacioni konfidencial i vendosur në dispozicion të bëhet publik dhe i disponueshëm nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi të të Marrësit.

Me nënshkrimin dhe paraqitjen e një kopje të këtij dokumenti në Albpetrol Sh.A, Unë konfirmoj se i kuptoj dhe pranoj parashikimet e mësipërme dhe bie dakord që t'i respektoj ato.

Për dhe në emër të: _____

Emri, pozicioni, nënshkrimi: _____

Data: _____